



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11268 Prot

Lezhë, më 31 / 7 /2023

VENDIM

Nr. 17, Datë 27. 07. 2023

**Për një ndryshim në Vendimin e KB nr.120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Vendimit të KM nr.113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi”; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e KB nr.120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023”, si më poshtë:

1/a- Pakësohet :

- Gr.00, Prog.01110, Kap.05, Art.231 në shumën 10,000,000 lekë me emërtim:“Blerje pajisje zyresh”.
- Gr.00, Prog.01110, Kap.05, Art.231 në shumën 500,000 lekë me emërtim: “Blerje kamera sigurie për bashkinë”.
- Gr.00, Prog.06260, Kap.05, Art.231 në shumën 1,000,000 lekë me emërtim; “Blerje pllaka varrezash”.
- Gr.00, Prog.09120, Kap.05, Art.602 në shumën 2,000,000 lekë me emërtim; “Blerje materiale pastrimi”.
- Gr.00, Prog.09120, Kap.05, Art.231 në shumën 600,000 lekë me emërtim: “Blerje kamera sigurie për shkollat”.
- Gr.00, Prog.09230, Kap.05, Art.231 në shumën 3,000,000 lekë me emërtim; “F/V Kaldaje Gjinnazi Lezhë”.
- Gr.00, Prog.03140, Kap.05, Art.602 në shumën 180,000 lekë me emërtim; “Blerje uniforma policie”.

- Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.602 në shumën 1,948,000 lekë me emërtim; “Blerje uniforma pune”.
- Gr.00, Prog.05100, Kap.05, Art.602 në shumën 300,000 lekë me emërtim; “Blerje uniforma pune”.
- Gr.00, Prog.06370, Kap.05, Art.602 në shumën 472,000 lekë me emërtim; “Blerje uniforma pune”.

**1/b- Shtohet :**

-Gr.00, Prog.08220, Kap.05, Art.231 në shumën 20,000,000 lekë për mbulimin e shpenzimeve të:

a-Ndriçimit skenik të sallës së koncerteve me vlerë 6,500,000 lekë.

b-Fonisë dhe audios së sallës së koncerteve me vlerë 3,500,000 lekë.

c-Arredimit të godinës së Pallatit të Kulturës me vlerë 10,000,000 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI  
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

103.  
Nr. 11268/1. Prot  
D. 3.8.2023

Nr. SPS/18 Prot.

Lezhë, më 03.08.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar"; VKM-në nr 113, datë 01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në skallë vendi" si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.17, datë 27.07.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një ndryshim në VKB-në nr. 120 datë 2.12.2022 "Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2023".

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**